



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

QENDRA E KUJDESIT DITOR PËR FËMIJË DHE TË RINJ ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Nr. ____ Prot

Vlorë më, 26/05/2025

KRITERET E PRANIMIT PËR PËRFITUESIT E SHËRBIMEVE NË QENDRËN E KUJDESIT DITOR PËR FËMIJË DHE TË RINJ ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Qendra e Kujdesit Ditor për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuara (QKDFRAF), si strukturë e ngritur pranë Qendrës së Zhvillimit për Persona me Aftësi të Kufizuara (QZHPAK), Vlorë, mbështet me shërbime ditore fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara të grupmoshës 6 – 21 vjeç.

Në marrjen e vendimeve të pranimit, Qendra e Kujdesit Ditor dhe Komisioni Multidisiplinar Vendor i japin prioritet kriterëve e si më poshtë:

1. Përfituesi i shërbimit ka statusin e invalidit nga Komisioni Mjekesor i Caktimit të Aftësisë për Punë të Invalidëve (KMCAP);
2. Familja e përfituesit të shërbimit ndodhet në situatë vulnerabiliteti ekonomik;
3. Familja ka më tepër se një fëmijë me aftësi të kufizuara;
4. Familja ka në përbërje vetëm një prind/kujdestar;
5. Përfituesi i shërbimit i përket komunitetit rom ose egjiptian.